

Nr. _____ Prot.
Datë _____
Bashkia e Tiranës

KËRKESË

BASHKISË SË TIRANËS
DREJTORIA E TRANSPORTIT E TRAFIKUT RRUGOR
PËR T'U PAJISUR ME LIÇENCË/ÇERTIFIKATË PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE NË LINJËTË
RRREGULLT QYTETËSE ME FLOTË 100% ELEKTRIKE

JURIDIK
Faza e Parë

Unë i nënshkruari..... banues në adresë Tel Fax.....
Email.....

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për Transportet Rrugore” (i ndryshuar), ligjin nr. 8378, dt. 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), udhëzimin nr. 15, datë 24.07.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar), vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak, urdhërat/ urdhëresat e Kryetarit të Bashkisë, vendimin nr. 520, datë 13.07.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 325 datë 19.03.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumentave zyrtare, të caktuara për këto operatorë (i ndryshuar), udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, për “Kriteret, rregullat dhe dokumentacioni për lëshimin e liçencave dhe certifikatave, për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve me autobus brenda vendit” (i ndryshuar).

KËRKOJ: Pajisjen me Liçencë/çertifikatë për transportin e udhëtarëve për linjën:
me mjetet:.....

Bashkëlidhur dorëzoj dokumentet e mëposhtme:

- 1.Kërkesën e aplikantit (te përmbajë, llojin e veprimtarisë që kërkon të kryejë dhe adresën e plote të selisë/filialit, numrin e telefonit, faksit, email etj).
- 2.Ekstraktin aktual mbi historikun e subjektit, lëshuar nga QKB.
- 3.Dokument që vërteton se kapitalet/asetet e subjektit nuk janë në duart e përbarimit apo sekuestruar, lëshuar nga Zyra e Përbarimit.
- 4.Dokument që vërteton se subjekti nuk është dënuar për shkelje të ligjeve të transportit lëshuar nga DPSHTR.
- 5.Deklaratën (të mbajtur përpara noterit) që merr përsipër plotësimin e parametrave tekniko-ekonomik të përcaktuara nga autoriteti liçencues, në rast të shpalljes fitues.
- 6.Programi vjetor ekonomik – financiar dhe i zhvillimit të veprimtarisë për biznesin që parashikohet të ushtrohet (plan biznesi). Në rastin e linjave me 100% të flotës së mjeteve elektrike, në plan biznes kosto e energjisë për karikimin e mjeteve elektrike të linjës, do të përlogaritet nga subjekti dhe Bashkia Tiranë merr përsiper të ndërmarë iniciativat e nevojshme për realizimin e këtij procesi nëse e vlerëson të realizueshëm.
- 7.Dokumentin që provon gjendjen e përshtatshme financiare, (Garanci bankare në vlerën 140000 lekë për mjetin e pare dhe 70 000 lekë për çdo mjet shtesë).
- 8.Dokumentin e zotërimit të kompetencës profesionale dhe eksperiencës, kontratën e punësme kohëzgjatje pesëvjeçare, me person që plotëson kriterin e kompetencës profesionale (ÇKP) (fotokopje të noteruar) person i punësuar deklaron përpara noterit që nuk është i punësuar në më shumë se 3 subjekte brenda të njëjtit rreth ose që nuk menaxhon më tepër se 36 mjete.
- 9.Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore për drejtuesin e veprimtarisë dhe administratorin e saj (fotokopje e dokumentit të identifikimit).
- 10.Kontratën me agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi (fotokopje e noteruar).
- 11.Listën me targat e automjeteve që do të përdorë (në formë përshkrimi dhe katalogu fotografik).

12. Lejet e qarkullimit (kontratat e qiramarrjes apo huasë), (në rast se në lejet e qarkullimit nuk është pasqyruar kontrolli teknik periodik i automjeteve të paraqitet fotokopje e noteruar e certifikatës së kontrollit teknik periodik të tyre).

13. Referencën dhe çdo dokument tjetër që vërteton eksperience në transportin e udhëtareve.

Të gjitha subjektet që do të aplikojnë për licencim në linjat qytetëse të reja apo të mbetura vakant, të cilat do të jenë me 100% të flotës së mjeteve elektrike, në fazën e parë të aplikimit, krahas dokumentacionit të kërkuar do të dorëzojnë edhe projekt idetë/deokumentacionet dhe skicat përkatëse shtesë, në format si më poshtë kërkuar:

a. Grafikon e futjes se mjeteve per realizimin e frekuences se kerkuar duke parashikuar dhe grafikon e karikimit per realizimin e autonomise se kerkuar te levizjes.

Subjekti ne fazen e konkurimit duhet te pasqyroje grafikon futjes se mjeteve per realizimin e frekuences se kerkuar ne oret e pikut si dhe pergjate te gjithe periudhes ditore te sherbimit, duke pasqyruar edhe frekuencat e tjera perkatese te sherbimit si dhe raportin me numrin e mjeteve te sherbimit duke perfshire (hyrjen ne linje dhe deri momentin e daljes nga linja). Gjithashtu subjekti duhet te paraqese dhe argumentoje kohen e qendrimit te stacionet fundore si pike e ri furnizimit me energji elektrike te mjetit, nese ne propozimin e pasqyruar eshte e nevojshme per realizimin e autonomise se kerkuar te levizjes.

b. Stacionet e furnizimit me energji elektrike

Subjekti duhet te pergatise ne propozimin e tij planin konceptual inxhinierik dhe vizatimet perkatese per stacionet e furnizimit me energji elektrike si ne parkun e qendrimit te mjeteve ashtu dhe ne stacionet e furnizimit me energji elektrike pergjate linjes, nese ne propozimin e paraqitur argumentohet nevoja e ketyre te fundit me qellim ruajtjen e autonomies se mjetit pergjate sherbimit.

**Bashkia Tiranë merr përsipër në bashkëpunim me institucionet përkatëse, për sjelljen e rrjetit elektrik pranë stacionit të karikimit të propozuar.*

c. Projekti infrastrukturor duhet te pasqyroje:

- 1. Projekt idea paraprake pasqyruar ne hartat me relief topografik te vendendodhjes se parkut te autobuseve ashtu dhe stacioneve te e furnizimit me energji elektrike ne linje nese ka te tilla.*
- 2. Analizë e situatës ekzistuese.*
- 3. Skemën e qarkullimit parkut te autobuseve dhe ne stacionet e furnizimit me energji elektrike.*
- 4. Profilin gjatësor të stacioneve te pikave e furnizimit me energji elektrike.*
- 5. Profilat tërthorë të stacioneve te pikave te e furnizimit me energji elektrike*
- 6. Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.*
- 7. Ndryshimet e mundshme te infrastruktures rrugore duke perfshire dhe prerjet terthore si dhe zgjidhjen per rrjetet perkatese inxhinierike.*
- 8. Sinjalizimin vertikal dhe horizontal.*

d. Raportimi

- 1. I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje origjinal, dhe në version të dixhitalizuar Cad (të cilat të transferohen në GIS) si edhe në 3 (tre) CD.*

2. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi.

e. Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimum fletët si më poshtë:

1. Sipas konceptit të propozimit, topografinë e gjëndjes egzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha hapesirat, ndërtimet dhe rruga në gjëndjen e sotme lidhur me parkun e autobuzeve dhe stacionet ku do vendosen pikat e furnizimit me energji në Shk. 1:500 ose 1:1000;
2. Sipas konceptit të propozimit planimetria e sistemimit të parkut të autobuzeve dhe stacionit në Shk. 1:500 ose 1:1000;
3. Profili gjatësor Shk. 1:1000, 1:100;
4. Profilat tërthorë
5. Detaje konstruktive tip të shtresave të infrastruktures
6. Detaje të rrjetit të kanalizimeve;
7. Planimetri dhe detaje për levizshmeri/sinjalistikën rrugore (Format A3);

f. Projekt Koncepti duhet të jete i certifikuar nga:

1. Inxhinier ndërtimi për rrugë;
2. Inxhinier gjeolog;
3. Inxhinier topograf;
4. Inxhinier elektrik;
5. Arkitekt;
6. Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

g. Bateria e propozuar dhe sistemi i furnizimit me energji

1. Te dhena teknike të baterise së mjetit të propozuar
2. Te dhena mbi afatin maksimal në shërbim të baterise së mjetit, kohën kur duhet zëvendësuar si dhe po ashtu performancën së saj në vite shërbimi
3. Te dhena teknike të pajisjes që mundëson furnizimin e mjeteve me energji elektrike
4. Grafikon e karikimit të mjeteve dhe skenaret e mundshme me ngarkesë maksimale
5. Raport teknik mbi mënyrën e menaxhimit të fuqisë së kerkuar nga sistemi i furnizimit me energji elektrike, në raport me numrin e mjeteve, kohën e karikimit dhe mbulimin e shërbimit
6. Nderhyrje të mundshme që mund të kerkohen në rrjetin kryesor të furnizimit me energji elektrike të shoqëruar me një raport teknik.

Si dhe çdo dokumentacion tjetër të kërkuar nga Bashkia e Tiranës.

KËRKUESI _____

Plotësohet nga specialisti i Bashkisë

(SPECIALISTI) _____

Tiranë, më / /

1. Tarifa për pajisje/rinovim licencë transporti të udhëtarëve në linjë të rregullt qytetëse me afat vlefshmërie 10 vjet është 80,000 lekë.
2. Tarifa për pajisje/rinovim certifikatë transporti të udhëtarëve në linjë të rregullt qytetëse me afat vlefshmërie 5 vjet është 5000 lekë